



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:019527
Datë: 20.09.2024
Numri i dokumentit: 06188361

C-IV-13-1054

Paditësi:

A B, Prizren.

Kundër

E paditura:

NSH ‘‘KOMUNA’’ Prizren (në likuidim).
Agjencia Kosovare e Privatizimit,(AKP) Rr. ‘‘Driton Hoxha’’, nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), më gjyqtaren Ganimete Puka, më 20.09.2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** në tersi si e bazuar padia e paditësit, dhe **NDRYSHOHET** vendimi i AL, nr. PRZ035-0172, të datës 10 qershor 2013.
- II. OBLIGOHET** Agjensioni Kosovar i Privatizimit (AKP)– Autoriteti i Likuidimit të NSH ,, Komuna,, Prizren, që në emër të kompensimit të pagave të pa paguar për periudhën 18.01.1994 deri më 03.12.1997, paditësit A B t’ia paguaj shumën prej 14,541.60 €, (katërmbëdhjetë mijë e pesëqind e katër dhjetë një euro e gjashtëdhjetë centë) dhe në emër të interesit ligjor prej 10 % të shumës themelore, t’i paguaj shumën prej 1.454.00 €, (njëmijë e katërqindën e pesëdhjetë e katër euro).
- III. SHUMA** e aprovuar si në pikën II të dispozitivit do të përmbushet në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.
- IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 28 qershor 2013, paditësi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, kërkesë kundër Vendimit nr. PRZ035-0172, të datës 10 qershor 2013, të Autoritetit të Likuidimit (tutje AL) më të cilin ka

kërkuar, që të rishikohet vendimi i AL-së me nr. të lartcekur dhe të detyrohet e paditura, që në emër të kompensimit të pagave të pa paguar për periudhën 18.01.1994 deri më 03.12.1997, paditësit ,t'ia paguaj shumën prej 14,541.60 €. Paditësi ka pohuar së në NSH ka punuar deri vitin 1994 kur është larguar nga puna, në mënyrë të paligjshëm. Tutje paditësi ka shtuar së ka fituar procesin gjyqësorë më Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren, C.nr.286/94, i dt.08.07.1997, i plotfuqishëm me dt.27.10.1997, që paditësi të kthehet në vendin e punës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që dalin nga marrëdhënia e punës përfshirë kompensimin e pagave të pa paguar . Paditësi pohon së kërkesa e tij gëzon mbrojtje ligjore në bazë të nenin 25 të Kartës Sociale Evropiane, e aplikueshme në Kosovës, që citon së të gjithë punëtorët kanë të drejtë për mbrojtjen e tyre në rast të falimentimit të punëdhënësit. I ka propozua gjykatës që t'ia aprovoj në tersi kërkesën e tij si të bazuar.

Paditësi në mbështetje të kërkesës së tij, ka dorëzuar këto prova: vendimin e AL-së të dt.12.06.2013, Aktgjykimin C.nr.286/94, propozimin për ekzekutim e dt. 12.01.1998, ekspertizën financiare te dt.25.12.1997, aktvendimin e Gjykatë së Qarkut në Prizren, E.nr.67/06, dt.06.04.2006, ekspertiza financiare, dt.03.04.2008.

Me 12 dhjetor 2013, e paditura AKP-ja parashtron mbrojtjen në ankesë ku pohon se AL-ja ka bërë një vlerësim të sakte të rrethanave faktike duke u përcjell nga zbatimi i saktë i dispozitave ligjore të zbatueshme. E paditura pretendon së ankuesi ka qenë i obliguar që të ofron të gjitha dëshmitë që mbështesin kërkesën e tij . Ankuesi jo vetëm qe nuk ka ofruar dëshmitë përkatës por as nuk ka përmendur propozimin për ekzekutim të cilin e ka paraqitur. E paditura pretendon së Aktvendimi është i parashkruar edhe pse parashtruesi ka paraqitur një propozim për ekzekutim, pasi që propozimi i ekzekutimit është dorëzuar në Gjykatën Komunale në Prizren , me 12 janar 1998, deh sipas nenit 379 te LMD , parashkrimi ka përfunduar me 12 janar 2008 dhe paditësi nuk ka ndërmarr ndonjë veprim për te ndërprere parashkrimin, kështu qe vendimi është parashkruar. E paditura propozon që Gjykata të refuzoj ankesën si te pa bazuar dhe te vërtetoj vendimin e AL-se.

Më 20 mars 2014, ankuesi ka parashtruar përgjigje ndaj mbrojtjes së AKP-së, me anë të së cilës i ka kundërshtuar të gjitha pretendimet në mbrojtje të AKP-së dhe ka kërkuar që të aprovohet kërkesa e tij për paga të papaguara si dhe ka parashtruar të gjitha dokumentet e nevojshme tek AL-ja si dhe në DHPGJS. Andaj, pretendon se kërkesa e tij nuk është e parashkruar por është e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet të përmbushet nga AL-ja.

Më datë 28 prill 2014, e paditura AKP ka dorëzuar në DHPGJS kundërpërgjigje ndaj përgjigjes së ankuesit , ashtu që mbetet në tërësi pranë pretendimeve dhe qëndrimin ligjor të saj të paraqitura në mbrojtje të dt. 12 dhjetor 2013. Ashtu që e paditura prape e thekson së ankuesi nuk e benë dallimin mes afatit për parashtrim të kërkesave dhe afatit të parashkrimit dhe së dyti ankuesi pretendon se AL-ja mbi bazën e nenit 2.2 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034, duhet te kishte kërkuar informata plotësuese nga Parashtruesi në vend se të refuzoj kërkesën. Për këto arsye e paditura i propozon gjykatës që të refuzoj ankesën si të pabazuar dhe të vërtetoj vërtetimin e AL-së në pajtim me nenin 70.4 të Shtojcës se Ligjit nr. 04/L-033.

Në lidhje me detajet tjera, gjykata i referohet shkresave të lëndës dhe parashtrësive të palëve.

Arsyetimi ligjor:

Padia e paditësit aprovohet në tërësi si e bazuar.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par. 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa, par.3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Është rregull ligjor dhe procedural që: *“Pagat - rrogat paguhen: të paktën çdo muaj punonjësit personalisht ose përmes transferit bankar dhe të shoqëruara me dëftesën e pagesës.*

Gjykata gjen së neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53/76), është i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 në të cilin ishte mbështetur vendimi refuzues i AKP-së por që AL me rastin e vendosjes nuk e ka zbatuar drejtë këtë dispozite meqë nuk ka marr në konsideratë ndërprerjen e përshkrimit që ka ndodhur tek rasti i ankuesit, prandaj vendimi i AL nuk është plotësisht i saktë dhe si i tillë duhet te ndryshohet. Dispozita e nenit 608 parashikon se kërkesat monetare që rrjedhin nga marrëdhënia e punës parashkruhen për 3 vite, ndërsa ku kemi një aktgjykim të plotfuqishme kërkesa parashkruhet për 10 vite, këtë e parasheh neni 379 i LMD/së.

Gjykata vlerëson se, për kohen kur pretendohet se është krijuar detyrimi, duhet të aplikohen dispozitat e atij Ligji. Gjykata gjithashtu vëren se me Ligjin e Punës nr. 03/L-212 i cili hyri në fuqi më 01 nëntor 2010, në dispozitat e tij qartësisht normon shfuqizimin e të gjitha Ligjeve ekzistuese të Punës në Kosovë. Megjithatë, edhe ky Ligji parasheh parashkrim në lidhje me pagesat e të ardhurave, neni 87, i këtij ligji, mirëpo baza ligjore duhet kërkuar në legjislacionin në fuqi sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, të datës 12 dhjetor 1999 e cila siç u tha më lartë në nenin 1.1 pika b, parasheh si Ligj në fuqi në Kosovë legjislacionin i cili ishte në fuqi në Kosovë me 22 mars 1989.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti së ankuesi ishte një punëtor i N.SH “Komuna ”, në Prizren. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës. I autorizuari i paditësit, pretendon se kërkesa e paditësit nuk është e parashkruar. Paditësi kishte dorëzuar propozimin për ekzekutim dy herë dhe atë në vitin 1998 si dhe në vitin 2006. Dhe sipas nenit 382 , 383 dhe 388, të LMD, i cili ishte në fuqi në atë kohë, parashkrimi nuk rrjedhe gjatë kohës së mobilizimit në rast rrezikuar direk nga lufta dhe kemi ndërprerje të parashkrimit dy herë. E paditura e kundërshton , pretendimin e të autorizuarit të paditësit së afati i parashkrimi është ndërprerë, duke u thirru se paditësi nuk ka dorëzuar prova në AL, dhe mbet pranë prapësimit së kërkesa e paditësit është e parashkrua.

Gjykata gjënë së më Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren, C.nr.286/94, i dt.08.07.1997, i plotfuqishëm me dt.27.10.1997, paditësi e kishte fituar procesin gjyqësor në të gjitha instancat gjyqësore, mirëpo edhe për kundër këtij aktgjykimi të formës së prerë, punëdhënësi nuk e kishte respektuar vendimin gjyqësorë. Paditësi ishte detyruar për mes propozimit për ekzekutim të kërkoj kompensimin e pagave të pa paguara, propozimi për ekzekutim ishte dorëzuar në Gjykatë dt.05.01.1998, si dhe ishte kërkuar vazhdimi i procedurës së ekzekutimit me parashtresën e dt.22.03.2006, dhe ky fakt vërtetohet me Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren E.nr.67/06, dt.06.04.2006. Pastaj ankuesi kishte dorëzuar kërkesë pranë AL me dt.04.04.2008, kërkesë e cila ishte refuzuar nga AL, me pretendimin së kërkesa është e parashkruar.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara provat e shtjelluara më lart, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për N.SH-në, dhe pa bazë ligjor ishte largua nga punës, dhe tani kërkon kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën dt.18.01.1994 deri më 03.12.1997, në shumë prej 14.541.60€, pasi që konsideron së nuk janë të parashkruar.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 14.541.60€. gjykata i njeh ankuesit, duke u bazuar në propozimin për ekzekutim dt.05.01.1998, ekspertizës financiare dt.25.12.1997, si dhe ekspertizën financiare dt 03.04.2008 . E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.SH- në periudhën e lartcekur, apo se nuk i takon kompensimi për paga, gjersa lartësia e shumës së kërkuar nuk ishte kontestuar nga e paditura.

Gjykata vlerëson së për periudhën e kontestuar, parashkrimi është ndërprerë edhe nga dëshmitë tjera shtesë të cilat i ka prezantuar ankuesi para gjykatës siç janë: parashtresa Propozimi drejtuar Gjykatës komunale në Prizren, për pagimin e të ardhurave personale , vërtetohet së ankuesi në vijimësi që nga viti 1994 , e deri para Autoritetit të Likuidimit, në vitin 2008, ka kërkuar pagesën e të ardhurave personale të cilat N.SH-ja i ka mbetur borxh, dhe kërkesa nuk mundë të konsiderohet e parashkruar.

Gjykata ka vlerësuar , prapësimin e palës së paditurës në lidhje me parashkrimin e kërkesës , mirëpo një prapësimi i tillë është i pa bazuar dhe nuk gjend mbështetje ligjore. Me të gjitha

provat në shkresat e lëndës gjykata e mbron qëndrimin e të autorizuarit të paditësit se kërkesa e paditësit nuk është e parashkruar, pasi që u vërtetuar së ankuesi që nga viti 1994, 1998, për të vazhduar në vitin 2006 dhe e deri para AL në vitin 2008 , në vazhdimësi e kishte kërkuar të drejtën e tij për kompensimin e pagave të pa paguar, dhe kërkesa e ankuesi nuk është e parashkruar, këtë e dinë edhe e paditura. E paditura si në vendimin AL dhe në mbrojtje vetëm thirret së kërkesa e ankuesit është e parashkruar, ndërsa fare nuk lëshohet në arsyetimin e këtij prapësimi, duke cituar se paditësi nuk ka dorëzuar prova pranë AL, për të vërtetuar ndërprerjen e parashkrimit. Këtë qëndrim të paditurës gjykata e konsideron si të pa qëndrueshëm dhe në kundërshtim me të gjitha provat në shkresat e lëndës dhe të elaboruar me lartë, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 124.10 €, në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë i barët shpenzimet e veta procedurale.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Ganimete Puka

G j y q t a r e